

VENDIM
Nr. 534, datë 27.6.2013

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE,
BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3 dhe që i bashkëlidhet vendimit nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

“1. Në emërtesën e bordit/këshillit/komisionit, në funksion të Ministrisë së Punëve publike dhe Transportit, shtohet “Bordi i Menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”. Ky bord përbëhet nga 1 kryetar dhe 6 (gjashtë) anëtarë me të drejtë pagese përkatësisht në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për kryetarin dhe në masën 8 000 (tetë mijë) lekë për anëtarët, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 6 (gjashtë) pagesa në një vit buxhetor.

2. Në emërtesën e bordit/këshillit/komisionit, në funksion të Institutit të Statistikave, shtohet “Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën”. Ky komision përbëhet nga 1 kryetar dhe 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë me të drejtë pagese përkatësisht në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për kryetarin dhe në masën 8 000 (tetë mijë) lekë për anëtarët, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 3 (tri) pagesa në një vit buxhetor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha